

www.gjykataelarte.gov.al



REVISTA DIGITALE

DIALOG JURIDIK

REFLEKTIME GJYQËSORE

2026

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së ndryshimit të praktikës gjyqësore

- Rast nga praktika gjyqësore gjermane -

Përgatiti:

Prof. Asoc. Dr. Arta Vorpsi, PhD

Lektore e së drejtës kushtetuese

Interpretimi dhe zbatimi i njësuar i ligjit nga gjykatat më të ulta është misioni kushtetues i Gjykatës së Lartë. Për këtë qëllim, peshën më të madhe në vendimmarrjen e saj e zënë vendimet njësuere me qëllim orientimin e praktikës gjyqësore.

Gjithashtu, Gjykata e Lartë duhet të kujdeset që vendimet njësuere t'i qëndrojnë kohës dhe aktualitetit. Në të kundërt, roli i saj dobësohet dhe si rrjedhim edhe legjitimiteti i funksionit të saj për njësimin dhe zhvillimin e së drejtës zbehet. Për këtë qëllim, ajo duhet të analizojë nëse një vendim njësuar nuk përputhet më me praktikën ose frymën e ligjit. Identifikimi i *çështjes* dhe *momentit* për kalimin e çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore është me rëndësi, prandaj ai i kalon caqet e gjykimit të zakonshëm, duke marrë kontekst të mirëfilltë kushtetues.

Ndërsa për njësimin e praktikës, Gjykata e Lartë duhet të vlerësojë dhe konstatojë se ndodhet para *interpretimit të ndryshëm ose të gabuar të ligjit* nga gjykatat, për ndryshimin e saj, ajo duhet të bindet se *praktika ka devijuar nga kuptimi i njësimin të bërë prej saj më parë ose kuptimi i njësuar nuk i përgjigjet më frymës së legjislacionit ose marrëdhënieve juridiko-sociale të krijuara*. Pikërisht për këtë fakt, vlerësimi i nevojës për ndryshimin e praktikës gjyqësore kërkon një operacion intelektual të kujdesshëm nga ana e Gjykatës së Lartë, me qëllim që vendimi i saj ndryshues të mirëpritet dhe zbatohet me përpikëri.

Më poshtë paraqitet një rast nga praktika gjermane, lidhur me vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese Federale (GJKF) ndaj vendimit të Senateve të Mëdha të Gjykatës së Lartë Federale (GJLF) për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Në këtë vendim gjen shprehje analiza kushtetuese e vlerësimit të nevojës për ndryshim të praktikës, gjë e cila mund të jetë orientuese për GJL shqiptare, në situata të ngjashme. Me interes, gjithashtu, është edhe qëndrimi i pakicës, i cili përkrah një qëndrim më konservator lidhur me rolin e gjyqësorit kundrejt interpretimit të ligjit.

A. Rrethanat e çështjes:

Sipas një interpretimi të mëparshëm të Senateve të Mëdha (SM) të GJLF, ndalohej marrja si provë e thënies të pasqyruara në proces-verbal me qëllim përdorimin e tyre si shkak për rekurs. Pra, mangësitë e vërejtura në proces-verbal nuk mund të përdoren si shkak për rekurs në GJLF gjermane. Kodi Penal gjerman parashikon se vetëm nëse vërtetohet falsifikimi i proces-verbalit, atëherë mund të bëhet shkak për rekurs për shkelje të rënda procedurale (*Konstatimi i respektimit të procedurave në seancën gjyqësore provohet vetëm nëpërmjet procesverbalit të seancës gjyqësore*). Pasqyrimi apo jo i saktë i këtyre procedurave mund të kundërshtohet vetëm nëpërmjet vërtetimit të falsifikimit të tyre. Kjo praktikë ishte në fuqi prej vitit 1877.

Në një çështje konkrete, bazuar në rekursin për shkelje në mbajtjen e procesverbalit, kërkuesi pretendoi se shkelja ishte e rëndë, pasi në asnjë pjesë të procesverbalit nuk përmendet akuza e prokurorit, si rrjedhojë ai ishte dënues pa një akuzë të vlefshme. Ky pretendim provohet nga teksti i procesverbalit, por prokurori e konsideroi si lapsus.

Shumica e Senatit të Parë e konsideroi këtë si një shkelje të rëndë dhe si shkak për ndryshimin e praktikës gjyqësore të deriatëhershme. Senati i Dytë dhe i Tretë iu bashkuan Senatit të Parë, kurse Senati i Katërt dhe i Pestë i qëndruan praktikës së deriatëhershme. Senati i Parë shtoi këtë pyetje para Senateve të Mëdha: *A duhet të marrë në konsideratë gjykata rishikuese fuqinë provuese të procesverbalit nëse ngrihet një pretendim për shkelje të tillë që sjell pasoja të pafavorshme për të pandehurin, gjë e cila provohet qartësisht nga ky akt procedural?*

B. Vendimi i Senateve të Mëdha që ndryshoi praktikën:

Korrigjimi i procesverbalit mund të sjellë një pasojë të pafavorshme për rekursuesin, i cili pretendon se procesi është bazuar mbi shkelje procedurale të rënda. Mbajtësit e procesverbalit në një rast të tillë, para se të korrigjonin atë, duhej të dëgjojnë kërkuuesin. Nëse ai nuk është dakord me përmbajtjen e korrigjuar, atëherë duhet të thirren edhe pjesëmarrës të tjerë në gjykim. Nëse mbajtësit e procesverbalit, me gjithë kundërshtimet e paraqitura, i qëndrojnë përmbajtjes së korrigjuar, vendimi i tyre duhet arsyetuar. Respektimi i korrektesisë së procesverbalit i nënshtrohet verifikimit në rrugën e pretendimit për shkelje të rënda procedurale nga gjykata që shqyrton rekursin. Në rast se gjykata që shqyrton rekursin nuk arrin në një konkluzion përfundimtar, procesverbali i pakorrigjuar do të konsiderohet i vlefshëm.

Ndaj këtij qëndrimi por tashmë në një rast tjetër gjyqësor, u ushtrua ankim kushtetues individual (AKI) në GJKF, me pretendimin se praktika e re e GJLF lidhur me vlefshmërinë e procesverbalit në procesin penal nuk është në pajtim me të drejtat kushtetuese të të pandehurit. Kryesisht pretendimi lidhej me tejkalimin e juridiksionit gjyqësor të GJLF në çështje që lidhen me të drejtat e pandehurit, duke krijuar normë të re, e cila është kompetencë e ligjvënësit dhe jo e gjyqësorit.

C. Vendimi i GJKF¹

GJKF vlerësoi se vendimi i GJLF nuk e cenon kërkuuesin në të drejtat e tij kushtetuese. Ky vendim respekton kufijtë kushtetues të interpretimit të së drejtës nga gjykatat. Interpretimi i së drejtës së zakonshme (duke nënkuptuar ligjet dhe aktet nënligjore) dhe zgjedhja e metodës së aplikuar për këtë qëllim është çështje e gjykatave të zakonshme dhe nuk i takon GJKF të verifikojë saktësinë e saj. GJKF ka për detyrë të kufizojë kontrollin e saj deri aty sa të sigurohet se kufijtë e kompetencave mes pushteteve që parashikohen nga neni 20/3 i kushtetutës (parimi i shtetit të së drejtës dhe ndarjes së pushteteve) janë respektuar. Pjesë e këtij kontrolli është verifikimi nëse vullneti i ligjvënësit është respektuar dhe nëse janë përdorur metodat e njohura dhe të pranura të interpretimit ligjor. Këto parime vlejné edhe në të drejtën procedurale penale. Jurisprudenca e re e GJLF për respektimin e korrigjimit të procesverbalit nuk paraqet shqetësim në këtë kontekst. Veçanërisht praktika e vazhdueshme e gjykatave penale që të konsiderojë pa kufizim në kohë një korrigjim të procesverbalit gjyqësor nuk paraqet problem në këndvështrimin e kufijve kushtetues të interpretimit ligjor. Ndryshimi i praktikës së deritanishme që ndalonte çdo ngritje pretendimi në këtë drejtim është brenda kufijve të interpretimit ligjor.

Pretendimi kryesor i kërkuesi se ndryshimi i praktikës së gjykatave penale për moslejimin e korrigjimit të procesverbalit pa kufizim në kohë është në kundërshtim me sigurinë juridike, nuk ka baza kushtetuese.

Vetë ligji nuk përmban asnjë rregullim të shprehur lidhur me korrigjimin e mëvonshëm në kohë të procesverbalit gjyqësor. Gjithashtu, nga praktika gjyqësore rezulton se edhe kodi i procedurës

¹ Vendim i GJKF gjermane BVerfGE 122, 248, datë 15 janar 2009.

penale është i mangët në lidhje me çështjen e lejueshmërisë së korigjimit të procesverbalit dhe nuk është plotësuar nga ligjvënësi. Ndërkohë në vitin 1974 ligjvënësi bëri disa rregullime të normave që lidheshin me korigjimin dhe vlefshmërinë e procesverbalit gjyqësor në disa procedura, por la pa prekur ato të procesit penal. Fakti që ligjvënësi nuk e ka rregulluar këtë gjë në procesin penal nuk të çon detyrimisht në përfundimin se ai ka shfaqur vullnetin e tij për të mos e ndryshuar apo plotësuar një gjë të tillë edhe për të drejtën penale.

Vendimi i ri i GJLF nuk del tej vullnetit të ligjvënësit duke marrë si provë vetëm një procesverbal të korigjuar, mbi bazën e të cilit mund të ngrihen pretendime për shkelje procedurale. Zgjidhja e re e dhënë nga GJLF nuk bie ndesh me kuptimin dhe qëllimin e normës penale. Teksti i normës e lë të hapur çështjen se cili version i procesverbalit *origjinali* apo *i korigjuari* do të ketë fuqi provuese. Dispozita penale parashikon që verifikimi i respektimit të procedurave të parashikuara për seancën gjyqësore bëhet vetëm me anë të procesverbalit gjyqësor.

Edhe nëse i referohemi dokumenteve parlamentare për të realizuar interpretimin historik, nuk rezulton i shprehur konkluzioni se cili version i procesverbalit ka fuqi provuese ekskluzive. Për ligjvënësin ka qenë me rëndësi të lidhë drejtpërdrejt pretendimin për shkelje procedurale gjatë seancës me dokumentin procedural provues, pra procesverbalin, jo detyrimisht të përcaktojë se cili nga versionet e tij është vendimtar.

Edhe dispozitivi i shprehur në vendimin e ri të GJLF, që ndryshon rregullin e mëparshëm të vendosur po nga ajo gjykatë, se verifikimi i shkeljeve procedurale që lidhen me pasqyrimin e saktë të procedurave gjyqësore gjatë seancës mund të ngrihet në rrugën e rekursit, ku në rast dyshimi merret për bazë versioni i pakorigjuar, respekton kufijtë kushtetues të interpretimit gjyqësor të ligjit.

Pretendimi se GJLF ka ndryshuar një praktikë të konsoliduar prej dekadash nuk bazohet në shkaqe të natyrës kushtetuese. Përshtatja e praktikës gjyqësore me këndvështrime të reja, ashtu siç gjykohet të jetë ky rast, është brenda kuadrit të zhvillimit të së drejtës, gjë të cilën ligjvënësi e ka miratuar kur ia ka njohur GJLF këtë mision. Zbutja e formalizmit të fortë, i cili karakterizonte mendimin juridik të shekullit 19-të, duke favorizuar zgjidhje juridike që paraqitnin më pak rrezik (jo patjetër më shumë mbrojtje) vihen re në mjaft iniciativa të ligjvënësit, në interpretime gjyqësore të fushave të ndryshme të së drejtës. Këtu përfshihet edhe rekursi në çështjet penale.

GJLF nuk i ka kaluar kufijtë e interpretimit të së drejtës vetëm për shkak se ka hequr dorë nga një ndalim i mëparshëm i vendosur po me vendim gjyqësor. Nuk ekziston një ndalim i shprehur ligjor për ngritjen e pretendimeve për shkelje procedurale si rrjedhojë e procesverbalit jokorrekt. Këtë ndalim e ka vendosur praktika gjyqësore, duke bërë një interpretim tërësor të dispozitave procedurale penale.

Një nga detyrat e njohura dhe të pranura të pushtetit gjyqësor është që brenda kufijve të ligjit të verifikojë parimet juridike ku mbështetet legjislacioni dhe nëse e gjen me vend t'i zhvillojë ato më tej. Në raste të veçanta kjo mund të çojë edhe në heqjen dorë nga një interpretim i mëparshëm i normës juridike dhe përqafimin e një tjetër interpretimi më të përshtatshëm me kohën. Situata që krijohet për faktin se një koncept juridik i interpretuar nga gjykata ka gjetur zbatim për një kohë të gjatë, mund të shpjegohet dhe arsyetohet në vendimin e ri të asaj gjykate nëse është apo jo i pranueshëm ende, por nuk mund të krijojë problem të nivelit kushtetues. Vetëm fakti se një qëndrim është ndjekur për një kohë të gjatë nuk i jep atij vlefshmëri më të lartë e aq më pak garanci të nivelit kushtetues.

Kriteret kushtetuese mbi bazë të të cilave matet ndryshueshmëria e jurisprudencës gjyqësore janë të natyrave të ndryshme por gjejnë zbatim të njëjtë edhe në rastin kur një praktikë gjyqësore vendoset për herë të parë. Ndryshimi i vetëm këtu ka të bëjë me mbrojtjen e besimit tek gjyqësori. Interpretimi i ri i GJLF synon të vendosë kufijtë në ngritjen e pretendimeve për shkelje procedurale me qëllim lehtësimin e rekursit dhe njëkohësisht të kufizojë edhe tendencën e zgjerimit të praktikës gjyqësore në lidhje me mangësitë e dukshme de të qarta të procesverbalit gjyqësor. Mbrojtja kundrejt korrigjimeve të pasakta të procesverbalit gjyqësor, të cilat deri tani nuk i njihej kërkuesit, është rregulluar duke ia nënshtruar kontrollit në rrugën e verifikimit të rekursit. Ky nuk mund të konsiderohet si tejkalim i kufijve të interpretimit gjyqësor të së drejtës, ashtu siç nuk mund të thuhet edhe për interpretimin e parë, i cili vendosi ndalimin e tij, megjithëse nuk ishte në ligj i shprehur.

Këtu nuk luan rol as fakti që ndryshimi i praktikës gjyqësore sjell situatë të pafavorshme për kërkuesin. Parimi i ndarjes së pushteteve dhe detyrimi për t'iu nënshtruar ligjit imponojnë respekt ndaj vendimmarrjes së ligjvënësit për aq kohë sa është brenda kufijve kushtetues, pavarësisht përmbajtjes së saj dhe pavarësisht mënyrës dhe masës se si preket çdo individ. Kufijtë që vendosen nga këto parime kushtetuese vlejnë edhe për pushtetin gjyqësor dhe nuk mund të interpretohen as më ngushtë as më gjerë, duke u kufizuar tek fakti se interpretimi sjell pasoja të favorshme apo të pafavorshme për çdo të interesuar.

Shteti i së drejtës mund të realizohet vetëm nëse plotësohen kushte të mjaftueshme, midis të cilave edhe fakti që autorët e veprave penale të ndiqen penalisht sipas legjislacionit në fuqi, të gjykohen dhe t'u jepet dënimi i arsyeshëm. Mënyra se si organizohet procedura për këtë qëllim, kriteret dhe kushtet e ndjekjes penale nuk garantojnë ndonjë të drejtë specifike dhe as nuk cenojnë procesin e rregull ligjor në të drejtën penale të tilla që nëse pozicionet procedurale të pandehurit ose të dënuarit do të mateshin me rregullat e mëparshme procedurale, ato do të kishin krijuar një pozicion më të favorshëm në lidhje me të drejtat procedurale të tij. Korrigjimi i procesverbalit gjyqësor në kohë shmang vonesat në gjykim dhe kontribuon në përshejtimin e proceseve gjyqësore.

Jurisprudenca e gjykatave më të larta, brenda sistemit gjyqësor, nuk është ligj dhe nuk ka fuqinë e ligjit. Prandaj, heqja dorë nga interpretimi i deritanishëm i ligjit nuk bie ndesh me parimin e ndarjes së pushteteve dhe shtetit të së drejtës. Vlefshmëria dhe zbatueshmëria e interpretimit gjyqësor të normës juridike bazohet vetëm tek fuqia bindëse e argumenteve që jepen si dhe autoriteti dhe kompetencat e gjykatës. Nuk është e nevojshme të provohet ndryshimi thelbësor i marrëdhënieve juridike ose sociale apo i botëkuptimit publik që gjykata të bëjë një ndryshim të praktikës pa u konsideruar se bie ndesh me parimet kushtetuese të përmendura më lart.

Ndryshimi i praktikës së qëndrueshme gjyqësore nuk ngre dyshime nga pikëpamja dhe detyrimi për të mbrojtur besimin publik tek gjyqësori nëse ai argumentohet mjaftueshëm dhe qëndron brenda zhvillimeve të pritshme ose të parashikueshme të së drejtës. Ndryshimi i vlerës provuese të procesverbalit e respekton këtë detyrim pasi ka qenë një zhvillim i parashikueshëm. Prej vitesh ka pasur zëra kundër në vendime të kolegjeve të veçanta penale apo në literaturë.

Për sa më lartë, AKI është i pabazuar.

...

D. Mendimi i pakicës:

Shumica nuk respekton kufijtë kushtetues të interpretimit gjyqësor të normës juridike. GJLF me vendimin e saj ka cenuar nenin 20 të Kushtetutës (ndarja e pushteteve dhe shteti i së drejtës) duke

marrë kompetencat e ligjvënësit. Sipas kësaj dispozite gjyqësori i nënshtrohet kushtetutës dhe ligjeve. Pavarësia e gjyqësorit i shërben garantimit të paanshmërisë në zbatimin e ligjit, sidomos në rastet kur ka konflikte lidhur me interpretimin e tij. Edhe vetë gjyqtari i nënshtrohet ligjit. Të dyja mishërojnë parimin e ndarjes së pushteteve dhe të demokracisë. Me të dyja këto parime do të ishte i papranueshëm qëndrimi i gjykatave që i kthen ato nga zbatuese të së drejtës në krijuese të saj. Kjo do t'i zhvishte nga detyrimi për t'iu nënshtuar ligjit dhe së drejtës. Në bashkëveprimin midis legjislativit dhe gjyqësorit përparësi ka vullneti i ligjvënësit të legjitimuar drejtpërdrejt dhe në rrugë demokratike. Përparësia që i jepet ligjit nuk e ndalon gjyqtarin që të zhvillojë të drejtën, por kushtetuta i ka caktuar kufij kompetencës së gjyqtarit për të zhvilluar të drejtën.

Senati i GJKF, në një vendim të mëparshëm, ka konstatuar se një zhvillim gjyqësor i së drejtës që nuk përputhet me tekstin e qartë të ligjvënësit, ose nuk lexohet nga teksti i ligjit, ose nuk është lejuar nga ligjvënësi, shprehimisht apo heshturazi, cenon kompetencat e ligjvënësit demokratik. Nëse ligjvënësi ka marrë një vendim të qartë, gjyqtari, bazuar në përfytyrimet e tij politiko-juridike, nuk mund ta ndryshojë apo ta zëvendësojë me një zgjidhje gjyqësore, e cila gjendet jashtë parlamentit. Nëse ligjvënësi e ka shprehur apo jo qartazi vullnetin e tij, kjo arrihet nëpërmjet metodave të njohura të interpretimit. Për këtë qëllim duhet të nisemi nga këto parime:

- a) Pikë nisja për interpretim është teksti i dispozitës. Shpesh nuk ka mjaftueshëm informacion dhe të dhëna lidhur me arsyet objektive dhe subjektive ku është bazuar vullneti i ligjvënësit. Vetëm duke analizuar bashkërisht kuptimin dhe qëllimin e ligjit mund të nxjerrim thelbin e tekstit dhe të marrim përgjigje për mënyrën dhe arsyen e shprehjes së vullnetit të ligjvënësit, i cili nuk mund të kundërshtohet nga gjyqtari. Detyra e këtij të fundit është e kufizuar të nxjerrja e konceptit të rregullit juridik dhe zbatimi i tij në rastin konkret në mënyrën më të saktë të mundshme. Në asnjë rast nuk duhet që interpretimi gjyqësor i normës të përplasë me qëllimi e saj, apo ta deformojë atë, apo aq më pak ta zëvendësojë qëllimin e shprehur të ligjvënësit me të vetin.
- b) Për t'iu përgjigjur pyetjes cili është koncepti ku bazohet ligji, krahas materialeve legjislative dhe sistematikës ligjvënëse vjen në ndihmë edhe kuptimi që ka marrë dispozita në praktikë, sidomos kur është rasti i zbatimit të normës për një periudhë të gjatë dhe në një mënyrë të njësuar. Nëse praktika gjyqësore e ka zbatuar për një periudhë të gjatë një normë sipas një koncepti të caktuar, kjo situatë nuk mund të kalojë pa u vlerësuar.
- c) Qartësia e interpretimit të vullnetit ligjvënës nuk mund të relativizohet deri aty sa që të nënkuptohet se norma, kur zbatohet për një kohë më të gjatë, mund të ofrojë edhe interpretime të tjera, të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen nga ligjvënësi dhe si rrjedhojë mund të plotësohen nga gjyqësori. Përndryshe ligjvënësi do ta kishte të pamundur të rregullonte një situatë për një periudhë të gjatë, sepse sakaq vullneti i tij do të ishte zëvendësuar nga vullneti i gjyqësorit që i ka dhënë një kuptim të ndryshëm në praktikë asaj që ai ka rregulluar me normë.
- d) Për sa kohë ligjvënësi pas nxjerrjes së normës nuk vepron për ta plotësuar apo ndryshuar, kjo nuk nënkupton që ai pajtohet në heshtje me mënyrën se si zbatohet norma në praktikë, as që ai refuzon të ushtrojë rolin e tij rregullator për gjetjen e një zgjidhje të problemit që ekziston në praktikën gjyqësore. Ligjvënësi nuk ka asnjë detyrim që të rishikojë legjislacionin nga e para në mënyrë periodike.

Kontrolli kushtetues nuk shtrihet ndaj çdo shkelje gjatë zbatimit të ligjit. Ka dallime mes kontrollit kushtetues për shkelje në zbatimin e së drejtës dhe kontrollit lidhur me zhvillimin e ndërgjegjshëm të së drejtës duke krijuar rregulla të reja. Megjithatë çdo shkelje e gjykatave të zakonshme gjatë zbatimit të ligjit mund të sjellë një cenim të nenit 2/1 të ligjit themelor, GJKF kufizohet në

verifikimin e çështjes nëse gjykatat e zakonshme gjatë interpretimit dhe zbatimit të së drejtës kanë respektuar të drejtat themelore apo i kanë cenuar ato thelbësisht.

Në rastin e verifikimit të zhvillimit të së drejtës kemi të bëjmë me ndarjen e kompetencës midis pushtetit të parë dhe të tretë, e cila është çështje e mirëfilltë kushtetuese. Në këtë rast GJKF duhet të verifikojë nëse gjykata e zakonshme ka arritur të përçojë vullnetin e qartë dhe të dukshëm të ligjvënësit apo e ka zbehur atë duke e zëvendësuar me konceptin e vet, duke passjellë edhe mosrespektimin e detyrimit për t'iu nënshtruar ligjit. Këtu nuk luan asnjë rol fakti se modeli i zgjedhur nga gjyqësori është më i përshtatshëm apo më i saktë se sa modeli i ligjvënësit. Parimi i demokracisë dhe funksionaliteti i ligjit themelor do të dëmtoheshin vazhdimisht dhe rëndë nëse gjyqësori gjithmonë do të përpiqej të zëvendësonte vullnetin e ligjvënësit, apo do ta konsideronte si të papërshtatshëm sepse nuk ka vepruar ashtu siç pritet apo dëshiron gjyqësori.

Koncepte që rregullohen nga ligjvënësi qartë dhe dukshëm duhet të respektohen nga gjyqtari. Ndryshimi i ligjit është çështje e ligjvënësit. Çështja kryesore që shtrohet këtu është balanca e pushteteve sipas kushtetutës, e cila fokusohet tek krijimi i normës nga ligjvënësi dhe nënshtrimi i gjyqtarit ndaj ligjit, si dhe pavarësia e tij në interpretimin dhe zbatimin e tij. Jurisprudenca e GJKF e ka konsoliduar qëndrimin se në verifikimin që i bën zhvillimit gjyqësor të së drejtës duhet të përqendrohet në çështjen nëse vendimmarrja themelore e ligjvënësit është respektuar dhe nëse i ka ndjekur metodat e njohura për zhvillimin e së drejtës.

Zhvillimi gjyqësor i së drejtës i nënshtrohet të njëjtave premisa dhe kushte ashtu si dhe ligjvënësi, pavarësisht kompetencave të ndara. Nëse zgjedhja që bën gjyqtari i shërben zgjerimit të të drejtave themelore të parashikuara në kushtetutë, atëherë kufijtë për zhvillimin e së drejtës janë më të gjera, pasi kështu realizohet edhe detyrimi i ligjvënësit për të respektuar standardin kushtetues më të lartë. Në rast të kundërt, nëse të drejtat themelore pësojnë një kufizim apo shkurtim si rrjedhojë e interpretimit të ri gjyqësor, kufijtë e zhvillimit gjyqësor të së drejtës janë më të ngushtë dhe përgjegjësia e GJKF për të ruajtur kushtetutshmërinë rritet.

Ky ndryshim praktike i tejkalon kufijtë e interpretimit dhe merr rolin e ligjvënësit.

...